

BE DHE KLSH ME VIZION TË PËRBASHKËT KUNDËR KORRUPSIONIT

nga Fatos ÇOÇOLI – Ekspert i jashtëm¹

botuar në gazetën “Ekonomia”, më 1 shkurt 2014



Në analizën vjetore të KLSH të zhvilluar pak ditë më parë, Ambasadori i BE-së në Shqipëri, Ettore Sequi tha një gjë shumë të rëndësishme. Ai përafroi përpjekjet e KLSH për bashkëpunim dhe sinergji mes institucioneve kryesore të Shtetit, që luftojnë korrupsionin, me vizionin e tij për përpjekje të orkestruara kundër fenomenit më të rrezikshme që gërryen shoqërinë shqiptare. Kjo dëshmon

vizionin e përbashkët të të dyja këtyre strukturave të rëndësishme.

Lufta kundër korrupsionit, në të cilën KLSH dhe institucionet e tjera shtetërore duhet të angazhohen, si dhe pritshmëritë e opinionit të gjerë publik në lidhje me punën tonë në këtë drejtim, parashtrajnë kërkesën e kryerjes së kësaj lufte në vazhdimësi, pa kompromis dhe ndaj çdo institucioni apo nëpunësi të infektuar prej virusit të korrupsionit.

Kjo kërkesë e domosdoshme për arritjen e një standardi të pranueshëm mirëqeverisjeje, imponon nevojën e pasjes së një vullneti të fortë dhe konstant institucional në mostolerimin e asnjë rasti korrupsioni, pavarësisht nivelit ku ai shfaqet apo shkallës së shtrirjes së tij.

Vullneti i KLSH për luftë konkrete kundër korrupsionit

Këtë vullnet dhe kontribut institucional, në forcimin e kulturës së ndëshkueshmërisë, sidomos ndaj zyrtarëve të lartë të administratës shtetërore, shkelës flagrant të ligjit dhe mosbesues ndaj ekzistencës së forcës ndëshkuese të shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka treguar në mënyrë konstante gjatë këtyre dy viteve të fundit ku në numrin e konsiderueshëm të rekomandimeve të tij për dhënien e masave disiplinore, largimit nda detyra si dhe bërjes së kallëzimeve

penale janë përfshirë nëpunës të nivelit të lartë drejtues të administratës shtetërore.

Fuqia e rekomandimeve të KLSH dhe efekti i madh pozitiv që ato mund të transmetojnë në pastrimin dhe mosripërsëritjen e elementëve korruptiv brenda institucioneve shtetërore, kanë një ndërvarje të pashmangshme me shkallën e zbatimit të rekomandimeve nga ana e institucioneve shtetërore, sidomos atyre të audituara.

Nevoja për ripërtëritje të Urdhrit të Kryeministrit

Në këtë drejtim, një rol tepër të rëndësishëm ka luajtur **edhe Urdhri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006** “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, auditit të brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave”.

Ky urdhër, për shkak të angazhimeve që ai imponon për një sërë institucionesh shtetërore në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, mbetet një ndihmesë e madhe për veprimtarinë tonë audituese si dhe akt i cili shpreh në vetvete vullnetin institucional të qeverisë në drejtim të marrjes në konsideratë të rekomandimeve tona dhe efektit të tyre parandalues e ndëshkues në luftën kundër korrupsionit.

Nisur nga shkalla e zbatueshmërisë së këtij urdhëri dhe e rezultateve që ai ka mundur të prodhojë deri më sot në praktikë, kërkohet që për vetë kushtet aktuale të administratës shtetërore si dhe nivelit të korrupsionit të perceptuar dhe konstatuar gjerësisht, ky Urdhër të përmirësohet dhe ripërtërihet në kuadër të ridimensionimit dhe rikonceptimit të luftës ndërinstitucionale kundër korrupsionit.

Kallëzimet penale, efekti ndëshkues i tyre

Gjatë vitit 2013, për personat përgjegjës (nëpunës të nivelit të lartë, të mesëm dhe ulët drejtues) për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi me pasojë shpërdorimin e fondeve publike dhe dëmtimin e pronës publike dhe shtetërore, KLSH ka bërë 38 *kallëzime penale* ndaj 94 personave.

Nga një analizë në vite numri i kallëzimeve penale të denoncuar në organin e prokurorisë gjatë harkut kohor të dy viteve 2012-2013 është rreth katër herë më shumë se kallëzimet penale të kryera në tre vitet se bashku 2009-2011 sikurse paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Punonjësit e kallzuar nga KLSH të pezullohen nga puna

Në lidhje me këto kallëzime, Kontrolli i Lartë i Shtetit referuar neneve 241 dhe 242 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar që deri në fazën e përfundimit të hetimeve për këta persona të merret masa e pezullimit të ushtrimit të detyrës në funksionet publike, pasi në këto kushte hetimi i këtyre çështjeve nga ana e Prokurorisë do të ishte më i plotë dhe do shmangte mundësinë e fshehjes, prishjes, manipulimit apo zhdukjes së provave. Pezullimi nga puna do të rriste kulturën e ndëshkueshmërisë në vendin tone dhe do ta bënte administratën publike më të përgjegjshme.

¹ Shkrime të tjera të botuara nga Fatos ÇOÇOLI për periudhën Janar–Qershor 2014:

- *Rekomandimet e KLSH rrisin ndikimin e tyre.*
(Botuar në gazetën "Ekonomia", më 05 shkurt 2014.)
- *KLSH-ja dhe kultura e ndëshkueshmërisë së abuzuesve publik.*
(Botuar në gazetën "Ekonomia", më 08 shkurt 2014.)
- *Si shpëtohen pensionet?*
(Botuar në gazetën "Panorama", më 11 shkurt 2014.)
- *Dhe integrimi rri e vështrohet...*
(Botuar në gazetën "Panorama", më 11 mars 2014.)
- *TIKA mbi 20 vite në Shqipëri.*
(Botuar në gazetën "Ekonomia", më 21 qershor 2014.)